



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO			
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS			
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA			
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO			
Planimar / Dotezuar Punëhena/Prodato Received/Delivered	27-04	2021	9 viti god year
Organ /Njësia Org./Unit	Pr Prot Pr. No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kohësna Quantity
SK/145/HCK	2030/2021		119



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.139/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Eshref Shabani-anëtar si dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën e datës 15.03.2021 me numër A.nr.139/2021, e parashtruar përmes postës së Kosovës me datë 11.03.2021 me numër R1386013, nga ankuesja me banim në Ranilluk, Komuna e Ranillukut, kundër Këshillit Prokurorial të Kosovës, në çështjen juridike "Vlerësim i rezultateve të punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 27.04.2021, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.139/2021 e datës 15.03.2021 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja e sistemuar në pozitë "Arkiviste", në Prokurorinë Themelore në Gjilan, sipas Akte emërimit të datës 24.10.2017, e pa kënaqur me Vlerësimin rezultateve të punës për vitin 2020 e cila është vlerësuar me notën e përgjithshme 2.76, me datë 31.12.2020 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim të vlerësimit të punës tek Mbikëqyrësja e drejtpërdrejte, për shkak të mos përgjigjes në kërkesën e saj nga mbikëqyrësja, me datën 22.01.2021 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave në Këshillin Prokurorial të Kosovës-Njësinë e personelit. Me datë 04.02.2021 me numër protokoll 148/2021, Udhëheqësja e Divizionit për Burime Njerëzore të Këshillit Prokurorial të Kosovës i është përgjigjur ankesës së ankuseses. Ndërsa ankuesja ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Udhëheqësja e Divizionit për Burime Njerëzore të Këshillit Prokurorial të Kosovës më datë 15.03.2021 .

Kundër përgjigjes së datës 04.02.2021, dhe të pranuar më datë 18.02.2021 ankuesja me datë 15.03.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2020, me pretendime ankimore se vlerësimi është bërë në kundërshtim me ligjin.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 19.03.2021, ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Këshilli Prokurorial i Kosovës. Këshilli me datë 29.03.2021 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Këshilli Prokurorial i Kosovës me dokumentacionin lidhur me këtë lëndë 1451/21.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesë A.nr.139/2021 me numër protokoll 1141/2021 të datës 15.03.2021 e parashtruar përmes postës së Kosovës me datës 11.03.2021 me numër R1386013, nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesa e datës 22.01.2021 e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave në Këshillin Prokurorial të Kosovës-Njësinë e personelit; Përgjigje në ankesë e datës 04.02.2021 me numër protokoll 148/2021 nga Udhëheqësja e Divizionit për Burime Njerëzore të Këshillit Prokurorial të Kosovës; Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2020; Përgjigje në ankesë e datës 29.03.2021 nga Këshilli Prokurorial i Kosovës me nr. protokoll 1451/21 prej 1/3 faqe; Akte emërimi i datës 24.10.2017; Përshkrimi i detyrave të punës (ka nënshkrim pa datë); Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2019; Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2018; Kërkesë e datës 31.12.2020 për rishqyrtim të vlerësimit të punës për vitin 2020 drejtuar Mbikëqyrëses së drejtpërdrejte; Zarf i datës 26.03.2021 nga Këshilli Prokurorial i Kosovës drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me nr.protokoll 465/2021; E-mail i datës 23.04.2021; Përgjigje nga Njësia e Burimeve Njerëzore të Këshillit Prokurorial, E-mail i datës 23.04.2021, bashkangjitur kopja nga lista e librit të pranimit të dokumentacioneve, për Prokurorinë Themelore në Gjilan të datës 16.02.2021.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka vërtetuar se ankesa e ankueses

është e pa bazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se ankuesja me datë 11.03.2021 përmes postës së Kosovës, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është e regjistruar me datë 15.03.2021, kundër vlerësimit të rezultateve të punës për vitin 2020, të datës 21.12.2020, dhe kundër përgjigjes së datës 04.02.2021 me numër protokoll 148/2021 të Udhëheqëses së Divizionit për Burime Njerëzore të Këshillit Prokurorial të Kosovës, për ankesën e datës 22.01.2021 të parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave në Këshillin Prokurorial të Kosovës, me pretendime ankimore se vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2020, është i kundërligjshëm me legjislacionin në fuqi që rregullon qështjen e vlerësimit të nëpunësve brenda institucionit, sepse është vlerësuar me notën e përgjithshme 2.76, nga Mbikëqyrësja e saj e drejtpërdrejte, dhe po ashtu pretendon se nuk ka marrë përgjigje nga mbikqyresi për rivlerësim sipas kërkesës së saj.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar provat e lëndës të ankuesit dhe organit të punësismit gjegjesishtë Këshillit Prokurorial të Kosovës, ka konstataura se pretendimet e ankueses lidhur me vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2020, është i pa bazuara sepse vlerësimi i rezultateve në punë i datës 21.12.2020 nga mbikqyrësja e drejtpërdrejtë e cila ankuesen e ka vlersuar me notën e përgjithshme 2.76, është bërë pozitiv e që është në pajtim me dispozitën ligjore të nenit 7 paragrafin 2 nën paragrafin 2.3 të Rregullores Nr. 19/2012 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunëseve Civil, ku përcaktohet se: "2. Objektivat dhe aftësitë vlerësohen me nota nga 1 deri në 5. Rezultati final i vlerësimit llogaritet sipas mesatares së fituar dhe pasqyrohet si vijon:.....2.3." Nga 2.5 deri më pak se 3.5 nënkupton "mirë", lidhur me paragrafin 3.3 të kësaj rregullore, përcaktohet se: "mirë", vlerësohen nëpunësit civil, të cilët i kanë arritur të gjitha objektivat e punës (përmes realizimit të të gjitha aktiviteteve) dhe kanë treguar aftësi dhe cilësi të pritshme", lidhur me këtë Kolegji ka konstatuar se ankuesja nuk ka ofruar dëshmi dhe prova të mjaftueshme me të cilat do të dëshmonte se vlerësimi i rezultateve të punës për periudhën nga data 01.01.2020 deri me datë 31.12.2020 për vitin 2020, ka qenë jo objektiv, i pa drejtë dhe në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Kolegji me rastin e shqyrtimit të lëndës dhe duke u bazuar në informacionet zyrtare me rastin e komunikimit me institucionin e atakuar me këtë ankesë ka konstatuar se për shkak që viti 2020 ka qenë vit i pandemisë botërore dhe se puna kryesishtë ka qenë me reduktime, përkatësishtë me staf esencial në punë në një pjesë të madhe të vitit 2020, andaj edhe konsideron se kjo është edhe një ndër arsyet se vlerësimi është në harmoni me angazhimin konkretë të ankueses gjatë vitit kalendarik 2020.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar provat e lëndës të ankueses dhe organit të punësismit, lidhur me pretendimin se nuk i është bërë rivlerësimi sipas kërkesës së datës 31.12.2020, është konstatuar se e njejta pasi ka nënshkruar formularin e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2020, nuk i ka paraqitur vërejtjet e saja në formular dhe nuk i është drejtuar udhëheqësit më të lartë administrativ të Institucionit, së bashku me kërkesën për rishqyrtim të vlerësimit, siç e përcakton dispozita ligjore e nenit 11 paragrafit 5 e Rregullores Nr.19/2012 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunëseve Civil, ku përcaktohet se: "5. Në qoftë se i vlerësuar i është i pakënaqur me vlerësimin, ai brenda dy (2) ditëve të punës i paraqet vërejtjet në formular dhe i dërgon te udhëheqësi më i lartë administrativ i institucionit së bashku me kërkesën për rishqyrtimin e vlerësimit", që në rastin konkret ankuesja, kërkesën e datës 31.12.2020 për rishqyrtim të vlerësimit, e ka dorëzura në zyrë të Burimeve Njerëzore të Këshillit Prokurorial të Kosovës, pa subjekt dhe në kundërshtim me dispozitën ligjore të potencuar më lartë.

Ndërsa në lidhje me pretendimet tjera të potencuara në ankesë e që nuk kanë bazë ligjore kolegji nuk u lëshua më shumë nga se konsideronë se nuk janë me ndikim që mund të kishte pasur vendim ndryshe nga dispozitivi sipas këtij vendimi.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga kryetari i kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.139/2021, datë 27.04.2021.

Zyle Milaku GOJNOVCI

Zyrtarë e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm në Këshillin Prokurorial të Kosovës;
- Udhëheqëses së Divizionit për Burime Njerëzore të Këshillit Prokurorial të Kosovës në Prishtinë
- Administratores së Prokuroris Themelore në Gjilan dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

